

Perceptimi i ankthit stomatologjik te studentët e Kolegjit UBT në Prishtinë

Yllka Rugova, Festina Bala, Rudina Kurteshi, Delvina Panxhaj, Jeta Kiseri Kubati

Autorë

Yllka Rugova, Festina Bala, Rudina Kurteshi, Delvina Panxhaj, Jeta Kiseri Kubati

Fakulteti i Stomatologjisë, Kolegji UBT, Prishtinë, Kosovë

Për korrespondencë

Jeta Kiseri Kubati

jeta.kubati@ubt-uni.net

ABSTRACT

The aim of this study was to assess the level of dental anxiety and the contributing factors among university students from various academic disciplines. A questionnaire with 17 questions was sent via email to the students currently enrolled at the University for Business and Technology (UBT) to analyze their perceptions, experiences, and emotional responses related to dental treatment. Findings revealed that 50% of respondents reported feeling anxious prior to a dental visit, primarily due to fear of pain (40%), dental instruments noise (29.2%), and injections (22.5%). The majority of students (88.1%) preferred engaging in calming conversations with their dentist as a method for anxiety management, whereas only a small proportion expressed openness to psychological counseling. This study highlights the need for more empathetic approaches and effective interventions to improve the dental experience and promote preventive oral healthcare among anxious patients.

Keywords: dental anxiety, university students, fear of the dentist, dental instruments, anxiety management, dentist-patient communication.

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohet niveli i ankthit stomatologjik dhe faktorët që ndikojnë në shfaqjen e tij tek studentët e Kolegjit UBT nga fusha të ndryshme studimi. Përmes një ankete me 17 pyetje, të shpërndarë përmes email-it, u analizuan perceptimet, përvojat dhe reagimet emocionale të studentëve në lidhje me trajtimet

stomatologjike. Rezultatet treguan se 50% e studentëve ndiheshin të shqetësuar para një vizite stomatologjike, kryesisht për shkak të frikës nga dhimbja (40%), zhurma e paisjeve stomatologjike (29.2%) dhe injeksioneve (22.5%). Shumica e studentëve (88.1%) preferuan biseda relaksuese me stomatologun si mënyrë për menaxhimin e ankthit, ndërsa shumë pak ishin të hapur për konsulta psikologjike. Ky studim kontribuon në identifikimin e nevojës për qasje më të ndjeshme dhe ndërhyrje efektive në trajtimin e pacientëve me ankth, me qëllim përmirësimin e përvojës dentare dhe rritjen e kujdesit oral preventiv.

Fjalët kyçe: ankthi dentar, studentë, frika nga dentisti, instrumentet dentare, menaxhimi i ankthit, komunikimi dentist-pacient.

Hyrje

Shqetësimi ose frika ndaj stomatologut (odontophobia) dhe procedurave stomatologjike është një fenomen i përhapur, i cili jo vetëm që mund të vështirësojë procesin e trajtimit nga ana e stomatologut, por gjithashtu mund të ndikojë rëndë në shëndetin dhe mirëqenien e pacientit [1].

Ankthi është një ndjenjë thellësisht njerëzore, që ka evoluar gjatë historisë sonë si një mekanizëm mbijetese, i cili e ka shoqëruar njeriun që nga koha e homininëve të parë. Ky emocion ka pasur një rol kyç në përshtatjen ndaj rreziqeve, dhimbjeve dhe sëmundjeve, duke kontribuar në mbijetesën e individëve përmes reagimit ndaj

kërcënimeve të jashtme [2]. Në kontekstin stomatologjik, ankthi paraqitet si një ndjenjë frike, stresi dhe shqetësimi që ndodh para, gjatë ose pas një trajtimi stomatologjik. Aktivizimi i sistemit nervor autonom gjatë përjetimit të ankthit ndikon në funksionet vitale si shtypja e gjakut, ritmi i zemrës dhe frymëmarrja, duke shkaktuar ndryshime fiziologjike që përfshijnë uljen e pragut të dhimbjes dhe shtimin e mundësisë për komplikime gjatë trajtimit [3]. Studimet nga vende të ndryshme kanë raportuar norma të prevalencës së frikës dhe ankthit stomatologjik prej 12.5% - 16.1% [4-7], kurse tek fëmijët nga 43,1% - 47,6% [8-11], dhe përafërsisht të ngjajshme me disa shtete të rajonit [12].

Përvojat negative me trajtimet stomatologjike janë ndër shkaqet më të zakonshme që kontribuojnë në zhvillimin e frikës dhe shmangies nga vizitat te stomatologu [13]. Gjithashtu, studimet e shumta raportojnë diferenca gjinore në raport me ankthin. Femrat shfaqin nivele më të larta ankthi krahasuar me meshkujt. Mosha është një tjetër faktor i rëndësishëm, pasi individët më të rinj priren të kenë më shumë ankth, ndërsa ai zvogëlohet me kalimin e kohës dhe rritjen e përvojës [14, 15]. Frekuenca e vizitave stomatologjike ndikon gjithashtu; sa më rrallë të jenë këto vizita, aq më i lartë është ankthi. Niveli i arsimimit dhe statusi socioekonomik janë po ashtu faktorë relevantë; individët me njohuri të thella për procedurat ose me qasje të kufizuara në kujdes shëndetësor kanë më shumë gjasa të përjetojnë ndjenja frike dhe pasigurie [13, 16].

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohet niveli i ankthit stomatologjik dhe faktorët që ndikojnë në shfaqjen e tij tek studentët e Kolegjit UBT nga fusha të ndryshme studimi.

Materiali dhe metoda

Në këtë hulumtim është përdorur anketa studimore për të analizuar faktorët që ndikojnë në paraqitjen e ankthit stomatologjik tek studentët e Kolegjit UBT. Anketa është realizuar përmes Google Forms dhe është në përputhje me parimet e Deklaratës së Helsinkit. Anketa u është dërguar përmes emailit studentëve të drejtimeve të ndryshme, duke përfshirë stomatologji, farmaci, ekonomi, shkenca politike, shkenca kompjuterike dhe arkitekturë.

Anketa ka qenë plotësisht anonime dhe është realizuar gjatë një periudhe kohore 3 mujore (tetor-dhjetor 2024). Nga gjithsej 344 pyetësorët e dërguar, janë mbledhur gjithsej 120 me përgjigje të vlefshme. Pyetësori është bërë sipas Corah me bp. (1978) e modifikuar [17], dhe ka përfshirë 18 pyetje, të cilat janë të ndara në 5 seksione:

Të dhënat demografike; Frekuenca dhe përvoja me kujdesin stomatologjik; DAS score (për matjen e nivelit të ankthit stomatologjik); Shkaqet dhe burimet e ankthit stomatologjik; Manifestimet fizike dhe menaxhimi i ankthit (Tabela 1).

► **Tabela 1** Forma e pyetësorit të përdorur në studimin "Perceptimi i ankthit dentar në mes të studentëve të Kolegjit UBT në Prishtinë".

I. Të dhënat demografike	
1. Gjinia	
Femër ☐	Mashkull ☐ Tjetër ☐
2. Mosha	
17-20 vjeçe ☐	21-24 vjeçe ☐ >24 vjeçe ☐
3. Vendbanimi	
Qytet ☐	Fshati ☐
4. Programi në të cilin studioni	
Shkenca kompjuterike	☐
Shkenca mjekësore	☐
Arkitekturë dhe inxhinieri ndërtimore	☐
Shkenca politike	☐
Menaxhment	☐
Biznes dhe ekonomi	☐
Stomatologj	☐
II. Frekuenca dhe përvoja	
1. Numri i vizitave te dentisti 12 muajt e fundit	
1 vizitë ☐	2 vizita ☐ 3 vizita ☐ më shumë vizita ☐
2. Arsyeja e vizitave stomatologjike	
Kontrolli i rregullt	☐
Dhimbe dhëmbi	☐
Trajtimi ortodontike	☐
Arsyet kozmetike	☐
Ndonjë arsye tjetër	☐
3. Gjendja emocionale para vizitës tek dentisti	
E qetë dhe relaksuar	☐
I shqetësuar ne ankth	☐
I disponuar	☐
Neutrale	☐
4. Si do ta vlerësonit nivelin tuaj të ankthit dentar?	
Të lehtë ☐	Të moderuar ☐ Të rëndë ☐
Nuk mund ta përcaktoj ☐	
III. Tregoni se sa ankth ju shkakton një vizitë dentare, nëse ndodh. Vendosni 'X' në kutinë përkatëse për secilën situatë.	
1. Nëse do të shkonit te dentisti për TRAJTIM NESËR, si do të ndiheshit?	
Aspak i/e shqetësuar ☐	Pak i/e shqetësuar ☐
Mjaft i/e shqetësuar ☐	Shumë i/e shqetësuar ☐
Jashtëzakonisht i/e shqetësuar ☐	
2. Nëse do të ishit ulur në DHOMËN E PRITJES (duke pritur për trajtim), si do të ndiheshit?	
Aspak i/e shqetësuar ☐	Pak i/e shqetësuar ☐
Mjaft i/e shqetësuar ☐	Shumë i/e shqetësuar ☐
Jashtëzakonisht i/e shqetësuar ☐	

3. Nëse do t'ju duhet të gerryeni (trajtoni) dhëmbin me instrumente dentare, si do të ndiheshit?
Aspak i/e shqetësuar ☐ Pak i/e shqetësuar ☐ Mjaft i/e shqetësuar ☐ Shumë i/e shqetësuar ☐ Jashtëzakonisht i/e shqetësuar ☐
4. Nëse do t'ju pastronin dhe lustronin dhëmbët, si do të ndiheshit?
Aspak i/e shqetësuar ☐ Pak i/e shqetësuar ☐ Mjaft i/e shqetësuar ☐ Shumë i/e shqetësuar ☐ Jashtëzakonisht i/e shqetësuar ☐
5. Nëse do të merrnit një injeksion- anestezion lokal në mishrat e dhëmbëve, mbi një dhëmb të pasëm të sipërm, si do të ndiheshit?
Aspak i/e shqetësuar ☐ Pak i/e shqetësuar ☐ Mjaft i/e shqetësuar ☐ Shumë i/e shqetësuar ☐ Jashtëzakonisht i/e shqetësuar ☐
IV. Shkaqet dhe burimet e ankthit dentar.
1. Arsyeja e frikës (ankthit) nga trajtimi dentar?
Injeksion ☐ Frika nga dhimbja ☐ Frika nga gjakderdhja ☐ Tingulli i dridhjes se instrumenteve ☐ E panjohur ☐
2. Cila procedurë dentare shkakton më shumë ankth?
Zhurma e instrumenteve ☐ Mbushja dhëmbit ☐ Nxjerrja e dhëmbit ☐ Anestezioni (gjilpera) ☐ Tjetër ☐
V. Manifestimet fizike dhe menaxhimi i ankthit.
1. Ndonjë manifestim fizik i frikës gjatë trajtimit dentar?
Dridhje ☐ Kokëdhembje ☐ Djersitje ☐ Marramendje ☐ Vështersi në frymëmarrje ☐ Tjetër ☐ Pa simptoma ☐
2. Kur mendoni se frika (ankthi) juaj është me i theksuar?
Natën e mëparshme ☐ Në pritore ☐ Gjatë trajtimit ☐ Pas procedurës ☐
3. Si do të preferonit të kontrolloni ankthin?
Këshillimi me psikologun ☐ Marrja e qetësuesve ☐ Meditimi dhe teknikat alternative të relaksimit ☐ Biseda relaksuese me stomatologun para intervenimit dentar ☐

Vlerësimi i ankthit stomatologjik

Për vlerësimin e nivelit të ankthit stomatologjik është përdorur shkalla e *Dental Anxiety Scale* (DAS) i modifikuar. DAS përbëhet nga pesë pyetje që përshkruajnë situata të zakonshme gjatë një vizite stomatologjike. Pjesëmarrësit janë udhëzuar të tregojnë nivelin e shqetësimit të përjetuar në secilën situatë duke shënuar një 'X' në njërin nga pesë alternativat: aspak i/e shqetësuar, pak i/e shqetësuar, mjaft i/e shqetësuar, shumë i/e shqetësuar, ose jashtëzakonisht i/e shqetësuar. Secila përgjigje është e vlerësuar me pikë nga 1 deri në 5 dhe totali i pikëve përdoret për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të ankthit stomatologjik të individit. Përveç seksionit të tretë që përmban shkallën e standardizuar DAS për matjen e ankthit stomatologjik, seksionet e tjera të pyetësorit janë ndërtuar në përputhje me modelet e zakonshme të përdorura në studime të ngjashme, duke përfshirë pyetje të strukturuar mbi të dhënat demografike, përvojat me kujdesin stomatologjik, burimet e ankthit dhe manifestimet fizike.

Rezultatet

Rezultatet nga të dhënat demografike treguan se pjesa më e madhe e të anketuarve (85%) ishin nga zona urbane, ndërsa vetëm 15% ishin nga zonat rurale (**Tabela 2**). Kur vlerësohet sipas gjinisë, 78.3% e të anketuarve ishin femra dhe 20.8% ishin meshkuj ndërsa 0.8% preferuan të mos specifikonin gjininë. Përsa i përket grupmoshës, 47.5% e studentëve ishin në grupmoshën 21-24 vjeç, 40% ishin në grupmoshën 17-20 vjeç dhe 12.5% ishin më të vjetër se 24 vjeç. Kjo grupmoshë arsyetohet me faktin se të anketuarit janë ende në periudhën e studimeve të tyre. Në lidhje me frekuencën e vizitave te stomatologu (**Tabela 3**), 43.3% e studentëve kishin vizituar stomatologun më shumë se tre herë gjatë 12 muajve të fundit, 28.3% kishin bërë dy vizita dhe 12.5% kishin vizituar stomatologun tre herë. Vetëm 6.7% e studentëve nuk kishin pasur asnjë vizitë.

Kur u pyetën lidhur me ndjeshmërinë (shqetësimin) para vizitave (**Tabela 4**), 50% e të anketuarve ndiheshin të shqetësuar për një takim të ardhshëm te stomatologu,

► **Tabela 2** Të dhënat demografike.

Kategoria	Përqindja	Numri i përgjigjeve (N=120)
Vendbanimi		
Urban	85%	102
Rural	15%	18
Gjinia		
Femra	78.3%	94
Meshkuj	20.8%	25
Pa përgjigje	0.8%	1
Grupmosha		
17-20 vjeç	40%	48
21-24 vjeç	47.5%	57
mbi 24 vjeç	12.5%	15

► **Tabela 3** Frekuenca dhe përvoja me kujdesin dentar.

Kategoria	Përqindja	Numri i përgjigjeve (N=120)
Frekuenca e vizitave brenda 12 muajëve		
Asnjë vizitë	6.7%	8
Një vizitë	9.2%	11
Dy vizita	28.3%	34
Tri vizita	12.5%	15
Më shumë vizita	43.3%	52
Ndjeshmëria para vizitës		
Ankth i lehtë	50%	60
Shqetësim gjatë pritjes	34.2%	41
Shqetësimi nga instrumentet	19.2%	23

duke e vlerësuar ankthin e tyre si të lehtë. Nga të anketuarit, 34.2% ndihen të shqetësuar gjatë kohës që prisnin në pritore, ndërsa 19.2% e studentëve ishin më të shqetësuar kur përdoren instrumentet rrotulluese. Pyetja 5 (frika nga injeksioni) dhe Pyetja 1 (nëse do të kishin trajtim ditën e nesërme) shfaqin nivelet më të larta të ankthit me mesatare përkatësisht 3.30 dhe 3.21.

Pyetja 4 (pastrimi dhe lustrimi i dhëmbëve) ka nivelin më të ulët të ankthit (1.44), duke sugjeruar që kjo procedurë konsiderohet më pak traumatike. Mesatarja mbi vlerën 3.0 tregojnë prani të ankthit mesatar ose të lartë te pjesëmarrësit (**Tabela 4**) (**Figura 1**).

Në lidhje me shkaqet e ankthit stomatologjik (**Tabela 5**), 40% e studentëve u shprehën se frika nga dhimbja ishte shkaku kryesor i ankthit, 29.2% ndiheshin të shqetësuar nga zhurma e paisjeve stomatologjike, ndërsa 22.5% kishin frikë nga injeksionet. Kur u pyetën për procedurat më shqetësuese, 39.5% e studentëve përmendën zhurmën e paisjeve stomatologjike, 35.3% nxjerrjen e dhëmbëve, dhe 29.4% injeksionet. Në lidhje me manifestimet fizike të ankthit, 58.8% e studentëve nuk ndienë asnjë simptomë të dukshme, ndërsa 11.8% e studentëve ndjenë dridhje, 10.9% ndjenë djersitje dhe 4.2% marramendje. Në lidhje me periudhën kur ankthi është më i theksuar, 57.4% e studentëve ndiheshin më të shqetësuar gjatë trajtimit stomatologjik, ndërsa 36.5% ndiheshin të shqetësuar kur prisnin në pritore.

Për menaxhimin e ankthit (**Tabela 6**), 88.1% e studentëve preferuan biseda relaksuese me stomatologun para trajtimit për të menaxhuar ankthin, ndërsa 14.4% e të tjerëve

► **Tabela 4** Rezultatet e Modified Dental Anxiety Scale (MDAS).

Pyetja	Niveli i shqetësimit:					Totali i pikëve	Mesatarja e pikëve
	Aspak	Pak	Mjaft	Shumë	Jashtëzakonisht		
E parë	15	20	15	65	5	395	3.21
E dytë	25	18	34	26	17	352	2.93
E tretë	18	38	25	32	7	320	2.77
E katërt	84	19	17	0	0	173	1.44
E pestë	4	28	34	36	18	396	3.30

Sqarim i pyetjeve

1. Nëse do të shkonit te dentisti për TRAJTIM NESËR, si do të ndiheshit
2. Nëse do të ishit ulur në DHOMËN E PRITJES (duke pritur për trajtim), si do të ndiheshit?
3. Nëse do t'ju duhet të gerryeni (trajtoni) dhëmbin me instrumente dentare, si do të ndiheshit?
4. Nëse do t'ju pastronin dhe lustronin dhëmbët, si do të ndiheshit?
5. Nëse do të merrnit një injeksion- anestezion lokal në mishrat e dhëmbëve, mbi një dhëmb të pasëm të sipërm, si do të ndiheshit?

► **Tabela 5** Shkaqet dhe manifestimet fizike të ankthit dentar.

Kategoria	Përqindja	Numri i përgjigjeve (N=120)
Simptomat e ankthit		
Asnjë simptomë	58.8%	71
Dridhje	11.8%	14
Djersitje	10.9%	13
Marramednje	4.2%	5
Koha më stresuese		
Gjatë trajtimit	57.4%	69
Gjatë pritjes në klinikë	36.5%	44
Shkaqet kryesore të ankthit		
Frikë nga dhimbja	40%	48
Tingulli i instrumenteve	29.2%	35
Frikë nga injeksionet	22.5%	27
Procedurat më shqetësuese		
Zhurma e instrumenteve	39.5%	47
Nxjerra e dhëmbëve	35.3%	42
Injeksionet (anestezia)	29.4%	35

► **Tabela 6** Menaxhimi i ankthit dentar.

Kategoria	Përqindja	Numri i përgjigjeve (N=120)
Metoda e menaxhimit		
Biseda relaksuese me dentistin	88.1%	106
Meditim / teknika relaksimi	14.4%	17
Këshillim psikologjik	7.6%	9

sugjeruan meditimn dhe teknikat alternative të relaksimit. Vetëm 7.6% e studentëve ishin të interesuar për këshillim psikologjik për të menaxhuar ankthin.

Diskutimi

Të dhënat tona tregojnë një vetëdijësim të kënaqshëm për shpeshësinë e vizitave te stomatologu me 43.3% e të anketuarve me më shumë se 3 herë në vit. Por një pjesë e tyre vizitojnë stomatologun vetëm kur kanë probleme akute. Këto të dhëna janë pjesërisht të ngjajshme me një studim të realizuar në Danimarkë, ku u vu re se vizitat e rralla te stomatologu, të motivuara vetëm nga prania e problemeve, mund të konsiderohen si një formë shmangieje nga trajtimi stomatologjik [18]. Ndërsa studime të tjera kanë treguar lidhjen midis kësaj sjelljeje shmangëse, mungesës së higjienës së mirë orale dhe prezencës së ankthit të lidhur me trajtimin stomatologjik [19]. Frika nga dhimbja, zhurma e paisjeve dhe ankthi gjatë trajtimit stomatologjik ishin arsyt kryesore të ankthit të studentëve që morën pjesë në hulumtim. Po ashtu, frika nga injektimi i anestezionit ishte e pranishme. Studimet




Figura 1 Shqetësimi sipas pyetjes. DAS vlerat.

e ndryshme ngajshem tregojnë ndikimin e injektimit të anestezisë lokale në paraqitjen e ankthit [20]. Në lidhje me menaxhimin e ankthit stomatologjik, shumica dërrmuese e studentëve (88.1%) preferonin biseda relaksuese me stomatologun para trajtimit, ndërsa vetëm një pjesë e vogël (7.6%) shprehën interes për këshillim psikologjik.

Përfundimi

Hulumtimi ynë dëshmoi se ankthi stomatologjik është i pranishëm në një masë të konsiderueshme te studentët universitarë të Kolegjit UBT, duke u shfaqur kryesisht përmes reagimeve ndaj procedurave invazive dhe elementeve shqetësuese të ambientit stomatologjik. Të dhënat e këtij hulumtimi sugjerojnë se zvogëlimi i ankthit stomatologjik mund të arrihet përmes komunikimit efektiv ndërmjet stomatologut dhe pacientit dhe zhvillimit të strategjive të personalizuar për menaxhimin e ankthit stomatologjik.

Literatura

- [1] Armfield JM, Slade GD, Spencer AJ. Dental fear and adult oral health in Australia. *Community Dent Oral Epidemiol*. 2009;37(3):220–30.
- [2] Facco E, Zanette G. The odyssey of dental anxiety: from prehistory to the present. A narrative review. *Front Psychol*. 2017;8:1157.
- [3] Hoffmann B, Erwood K, Ncomanzi S, Fischer V, O'Brien D, Lee A. Management strategies for adult patients with dental anxiety in the dental clinic: a systematic review. *Aust Dent J*. 2022;67(1):12–20.
- [4] Locker D, Poulton R, Thomson WM. Psychological disorders and dental anxiety in a young adult population. *Community Dent Oral Epidemiol*. 2001;29(6):456–63.
- [5] Bergius M, Berggren U, Bogdanov O, Hakeberg M. Dental anxiety among adolescents in St. Petersburg, Russia. *Eur J Oral Sci*. 1997;105(2):117–22.
- [6] Nicolas E, Collado V, Faulks D, Hennequin M. A national cross-sectional survey of dental anxiety in the French adult population. *BMC Oral Health*. 2007;7:12.
- [7] Carter AE, Carter G, Boschen M, AlShèaimi E, George R. Pathways of fear and anxiety in dentistry: a review. *World J Clin Cases*. 2014;2(11):642–53.
- [8] Fayad MI, Elbieh A, Baig MN, Alruwaili S. Prevalence of dental anxiety among dental patients in Saudi Arabia. *J Int Soc Prev Community Dent*. 2017;7(2):100–4.
- [9] Gaffar BO, Alagl AS, Al-Ansari AA. The prevalence, causes, and relativity of dental anxiety in adult patients to irregular dental visits. *Saudi Med J*. 2014;35(6):598–603.
- [10] Al-Namankany A. Assessing dental anxiety in young girls in KSA. *J Taibah Univ Med Sci*. 2018;13(2):123–8.
- [11] Shafi S, Alasmri A, Mustafa A, Alsaleh S, Awan KH. An assessment of dental anxiety in nonclinical setting among Saudi Arabian children using Abeer Children Dental Anxiety Scale. *J Dent Res Rev*. 2015;2(4):172–4.
- [12] Šimunović L, Špiljak B, Radulović M, et al. Relationship between children's and parents' dental anxiety: a cross-sectional study in six European countries. *Dent J (Basel)*. 2022;10(11):209.
- [13] Muneer MU, Ismail F, Munir N, et al. Dental anxiety and influencing factors in adults. *Healthcare*. 2022;10(12):2352.
- [14] White AM, Giblin L, Boyd LD. The prevalence of dental anxiety in dental practice settings. *Am Dent Hyg Assoc*. 2017;91(1):30–4.
- [15] Caltabiano ML, Croker F, Page L, et al. Dental anxiety in patients attending a student dental clinic. *BMC Oral Health*. 2018;18:48.
- [16] Fayad MI, Elbieh A, Baig MN, Alruwaili S. Prevalence of dental anxiety among dental patients in Saudi Arabia. *J Int Soc Prev Community Dent*. 2017;7(2):100–4.
- [17] Corah NL, Gale EN, Illig SJ. Assessment of a dental anxiety scale. *J Am Dent Assoc*. 1978;97(5):816–9.
- [18] Moore R, Birn H, Kirkegaard E, et al. Prevalence and characteristics of dental anxiety in Danish adults. *Community Dent Oral Epidemiol*. 1993;21(5):292–6.
- [19] Levitt J, McGoldrick P, Evans D. The management of severe dental phobia in an adolescent boy: a case report. *Int J Paediatr Dent*. 2000;10(4):348–53.
- [20] Fiest L, Milgrom P, Feinstein P, et al. Psychophysiological responses to dental injections. *J Am Dent Assoc*. 1985;111(4):578–83.